



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 13891/prot. Lezhë, më: 23-07-2026

PROJEKT-V E N D I M
NR. —, Datë 23-07, 2026

PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË “F K ENERGY” SH.P.K, PËR VENDOSJEN E ANTENËS PËR MATJEN E REZULTATEVE TË ERËS NË MALIN E RRENCIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN DHE PËR VENDOSJEN E ANTENËS PËR MATJEN E REZULTATEVE TË ERËS NË MALIN E KAKARRIQIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE, BASHKIA LEZHË

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", Udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar", pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin dhe për vendosjen e antenës për matjen e rezultateve të erës në Malin e Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja që jepet në përdorim për vendosjen e antenave dhe përdorimin e rrugës ekzistuese detajohet si mëposhtë:
 - **1.24** ha sipërfaqe kullësore, në ngastrën **15**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".
 - **0.22** ha sipërfaqe pyjore, në ngastrën **23b**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".

- **0.54** ha sipërfaqe kullosore, në ngastrën **22c**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
 - **2.4** km rrugë ekzistuese, në ngastrën kullosore **15**, ekonomia pyjore “Mali i Kakarriqit”.
 - **2** ha sipërfaqe kullosore, në ngastrën **55**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.09** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **40a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.4** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **39a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.73** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **39b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.53** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **43a**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.77** km rrugë ekzistuese, në ngastrën kullosore **42**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **0.34** km rrugë ekzistuese, në ngastrën pyjore **41b**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
 - **1.34** km rrugë ekzistuese, në ngastrën kullosore **55**, ekonomia pyjore “Mali i Rrencit”.
2. Afati për dhënien në përdorim është **1 vit** dhe vlera e qerasë është **1018050** (Një milion e tetëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Pjerin NDREU

